

# Statistikat e Transportit Hekurudhor

## Tremujori I, 2024


**Tiranë, më 29 Prill 2024:** Gjatësia e rretit hekurudhor në shfrytëzim në vend është 253 km. Në shfrytëzim janë linjat hekurudhore: Kufi - Gjorm 93 km, Durrës - Elbasan 76 km, Rrogozhinë – Fier 49 km dhe Fier – Vlorë 35 km. Transporti hekurudhor i mallrave kryhet në distanca 0 - 49 km dhe 50 - 150 km.

### Statistikat e Transportit hekurudhor, për tremujorin e parë 2024, paraqiten si në vazhdim:

Volumi i mallrave të transportuara nëpërmjet rrugëve hekurudhore është 127 mijë ton, duke shënuar ulje me 15,0 %, në krahasim me tremujorin e parë 2023.

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë në mijë ton-km rezultoi 4.399 nga 5.165 mijë ton-km në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke u ulur me 14,8 %.

**Fig 1: Transporti hekurudhor i mallrave, 000/ton-km**



**Burimi:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT

"Qymyri dhe linjiti, nafta bruto dhe gazi natyror" sipas klasifikimit NST 2007 (Nomeklatura e Statistikave të Transportit), zënë 98,5 % të mallrave të transportuar me hekurudhë , "Lëndë të para të ricikluara; mbetjet e ngurta ( bashkiake) dhe mbeturina të tjera" 0,9% "Metalet bazë; produktet metalike të fabrikua, përveç makinerive dhe pajisjeve" zënë 0,6 % (tab.1).

**Për publikim 29/04/2024**


**Tab 1: Mallra të transportuara me hekurudhë sipas NST 2007, në 000/ton**

| Nr | Kategoritë e mallrave të transportuara në hekurudhë                              | Mallra gjithsej në 000/ton |              |
|----|--|----------------------------|--------------|
|    |  | Tr I-2024                  | %            |
|    | <b>Gjithsej</b>  | <b>126,9</b>               | <b>100,0</b> |
| 1  | Qymyr dhe linjit; naftë bruto dhe gaz natyror                                    | 125,0                      | 98,5         |
| 2  | Metale bazë; produkte metalike të fabrikuara, përveç makinerive dhe pajisjeve    | 0,8                        | 0,6          |
| 3  | Lëndë të para të ricikluara; Mbetjet e ngurta (bashkiake) dhe mbeturinat e tjera | 1,1                        | 0,9          |

*Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT*

Në tremujorin e parë 2024, kanë përdorur transportin hekurudhor si mjet udhëtimi 873 pasagjerë, duke shënuar ulje me 47,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

**Fig 2: Numri i pasagjerëve në transportin hekurudhor, 000 pasagjerë/km**



*Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT*

**Eksportet/importet e mallrave me hekurudhë**

Në tremujorin e parë 2024, volumi i mallrave të tregtuara me hekurudhë (eksport dhe import) është 595 tonë. Volumi i mallrave të eksportuara me hekurudhë zë 0,1 % ndaj volumit gjithsej të mallrave të eksportuara në vend.

**Tab 2: Eksportet/importet e mallrave me hekurudhë, ton**

| Periudha | TR I-2022 | TR II-2022 | TR I-2023 | TR IV-2022 | TR I-2023 | TR II-2023 | TR III-2023 | TR IV-2023 | TR I-2024 |
|----------|-----------|------------|-----------|------------|-----------|------------|-------------|------------|-----------|
| Eksport  | 0         | 1.104      | 720       | 0          | 2.784     | 4.622      | 2.706       | 2.037      | 595       |
| Import   | 1.667     | 1.113      | 0         | 0          | 0         | 0          | 0           | 0          | 0         |

**Burimi:** Drejtonia e Përgjithshme e Doganave, llogaritjet INSTAT

# Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit në frekuencë tremujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

## Përkufizime

**Transport:** Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit hekurudhor, tokësor, detar dhe ajror.

**Transporti hekurudhor:** Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve që përdorin një automjet hekurudhor në një rrjet të caktuar hekurudhor.

**Gjatësia e shinave:** Për një seksion të caktuar hekurudhor është gjatësia midis pikës së mesme të ndërtesës së stacionit të nisjes dhe pikës së mesme të ndërtesës së stacionit të terminalit.

**Pasagjerë të transportuar me hekurudhë:** Do të quhet çdo pasagjerë që udhëton me mjetin hekurudhor, duke përfshirë personat e destinuar për shërbime në tren.

**Ton-kilometër (TKM)** - Njësia e matjes që përfaqëson lëvizjen e një ton kapaciteti të disponueshëm në një vagon kur kryhet shërbime për të cilat është përcaktuar një distancë kryesisht mbi një kilometër.

**Mallra të transportuara me hekurudhë** - Do të quhet çdo lëvizje malli që kryhet me mjet hekurudhor, duke përfshirë këtu ambalazhin dhe pajisjet siç janë konteinerët, paletet si dhe mjetet rrugore të mallrave të transportuara me hekurudhë.

**Tren-kilometër** - janë distancat në kilometra të përshkuara nga trenat.

**Eksportet:** Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i katërt, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

**Importet:** Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i katërt, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

**Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007):** Është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: transport rrugor, hekurudhë, transport ujor i brendshëm dhe transport detar.

*Të dhënat e transportit hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).*

## Shpjegimi i simboleve

**0** vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-regtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/transporti-dhe-aksidentet/>